



Prejeli H

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

№ 244 Prot

Vlorë, më 09.01. 2025

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, datë 10 Janar 2025.

### ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORË**

**PREFEKTIT TË QARKUT VLORË** ✓

Ju njoftoj se, **ditën e Premte , datë 10.01.2025, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4 si dhe Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” neni 60

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim”Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e datës 04.10.2024 në banesat e qytetarëve dhe shperblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”
2. Projektvendim”Për dhënien e grantit të menjëhershëm nga Buxheti i Shtetit, familjes së Z. Agim Selfo Meçanaj, trajtuar me banesë sociale me kosto të ulët me V.K.B nr. 6 dt. 29.01.2024”
3. Projektvendim “Për miratimin e zbatimit të banesave me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga Buxheti i Shtetit, miratimi i sistemit të pikëzimit, niveli minimal dhe maksimal të të ardhurave dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë familjet/individët që përfitojnë nga ky program”.

Komisionet e përhershme, do të mblidhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

**Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike**, do të mblidhet ditën e enjte, datë 09.01.2025, ora 10:00.

**Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet**, do të mblidhet ditën e enjte, datë 09.01.2025, ora 11:00.

**Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e enjte, datë 09.01.2025 , ora 12:00.**

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

**KRYETAR**

**Elpiniqi Mërkuri**

